PARANDALIMI I RADIKALIZIMIT DHE SHFAQJEVE TË URREJTJES NË NIVELIN E BAZËS

UDHËZIME PËR AUTORITETET LOKALE DHE RAJONALE



Tekst i miratuar më 20 tetor 2015 në kuadrin e strategjisë së Kongresit për të luftuar radikalizimin

The Congress
Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Parandalimi i radikalizimit dhe shfaqjeve të urrejtjes në nivelin e bazës

Udhëzime për autoritetet lokale dhe rajonale

Tekst i miratuar më 20 tetor 2015 në kuadrin e strategjisë së Kongresit për të luftuar radikalizimin

Tekst: Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës
Kopertina: OPTEMIS
Botuar në: mars 2016

Përmbajtje

I. **Rezoluta 384 (2015)**..... 5

II. **Memorandum shpjegues** 8

1. Hyrje..... 8

2. Përgjigjet ndaj radikalizimit: tri qasje plotësuese 11

3. Sigurimi dhe siguria si të drejta themelore 14

4. Strategjitë ndërinstitucionale: partnerët për ta kryer këtë punë..... 15

5. Veprimet në terren: çfarë mund të bëjnë qeveritë lokale?..... 16

6. Përfundime 19

I. Rezoluta 384 (2015)[1]

1. Sulmet terroriste në Paris dhe Kopenhagë, ku u përfshinë xhihadistë të armatosur duke shkaktuar një numër të përgjithshëm prej 14 viktimash dhe 10 të plagosurish, theksuan nevojën e qyteteve për të bërë më shumë për të trajtuar në mënyrë efektive ekstremizmin. Këto sulme kanë vënë në qendër të vëmendjes çështje me interes: rritja e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe sektarizëm brenda qyteteve, rreziku i rritjes së polarizimit në shoqëri dhe i stigmatizimit të disa komuniteteve, gjuha e urrejtjes në mediat sociale, si dhe rreziku i censurës dhe vetë-censura janë të gjitha rreziqet aktuale me të cilat përballen qytetet.

2. Në Rezolutën nr. 381 (2015), të miratuar në sesionin e marsit 2015, Kongresi u angazhua për përditësimin e teksteve përkatëse të Kongresit, të cilat promovojnë pjesëmarrjen e qytetarëve që jetojnë së bashku në diversitet, përfshirjen sociale dhe kohezionin, dialogun ndërkulturor dhe ndërfetar, krijimin e udhëzimeve për autoritetet lokale dhe rajonale në parandalimin e radikalizimin dhe shfaqjeve të urrejtjes në nivelin e bazës, dhe krijimin e një vegle pedagogjike për t'u përdorur nga përfaqësuesit e zgjedhur vendorë gjatë organizimit të aktiviteteve ndërkulturore dhe ndërfetare.

3. Individët mund të radikalizohen për një mori arsyesh, të tilla si mungesa e integrimit në shoqëri, mosangazhimi politik apo ekspozimi ndaj individëve, grupeve ose organizatave ekstremiste. Konteksti vendor, kulturor dhe shoqëror ka ndikim në procesin e radikalizmit, i cili reflektohet në përgjigjen e autoriteteve publike. Ndër këto, parandalimin dhe deradikalizimi (dmth., veprimet që kryhen për reintegrimin e personave të radikalizuar në shoqëri) dhe jo represioni janë veprime që përkojnë me qëllimin dhe kompetencat e autoriteteve lokale dhe rajonale.

4. Trajtimi i radikalizimit kërkon masa parandaluese të menduara me kujdes. Në kuadrin afatgjatë, parandalimi ka kosto më efektive dhe

1 I debatuar dhe miratuar nga Kongresi më 20 tetor 2015, në takimin e parë (shih dokumentin CG/2015(29)5FINAL, memorandumin shpjegues), raporter: Leen VERBEEK, Holandë (R, SOC).

racionale sesa luftimi i simptomave apo krizave të plota. Parandalimi është po ashtu zona e veprimit *par excellence* për autoritetet lokale, ku ato mund të jenë më efektive dhe ku kompetencat dhe mandatet e tyre janë më të rëndësishme. Në të njëjtën kohë, njohja e këtij roli të rëndësishëm çon në fuqizimin e qeverive lokale dhe u mundëson atyre të parashikojnë më mirë këto sfida dhe mundësi.

5. Kjo është kritike për respektimin e të drejtave të njeriut, për trajtimin e çështjes së mbrojtjes dhe sigurisë së qytetarëve në mënyrë të balancuar, duke peshuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e çdo veprimi. Kur prezantohen masa që mund të rrezikojnë të drejtat individuale, autoritetet publike duhet të mbajnë parasysh se jo vetëm shteti i së drejtës, por edhe qëllimi strategjik për të ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse duhet të udhëheqin veprimet e tyre.

6. Duke pranuar se radikalizmi mund të përfshihet më të mirë në nivelin më të afërt të individëve vulnerabël në komunitetet më të prekura, Kongresi u bën thirrje autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës për:

a. hartimin e strategjive lokale ndërinstitucionale, në bashkërendim me nivele të ndryshme të qeverisjes, duke përfshirë partnerët lokalë dhe zhvillimin e një plani veprimi që reflekton situatën lokale, formimin e organeve koordinuese dhe ndarjen e burimeve të nevojshme për të luftuar radikalizmin, dhe marrjen e masave konkrete që mund të ndiqen;

b. t'i komunikuar strategjitë dhe veprimet e tyre publikut të gjerë në mënyrë të balancuar dhe të përgjegjshme, duke i kushtuar theks të veçantë një diskursi koheziv, duke synuar prezantim të qartë të mesazhit, pa stigmatizuar grupe specifike, dhe duke siguruar që çështjet e sigurisë nuk e errësojnë detyrën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit;

c. inkurajimin e ngritjes së partneriteteve lokale të sigurisë, duke siguruar trajnime të mjaftueshme për aktorët e ndryshëm në proces, përfshirë mjekët në frontin e parë që punojnë me individë apo grupe

në rrezik, personelin e burgjeve, punonjësit socialë, mësuesit dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor, në mënyrë që të zhvillojnë të kuptuarit mbi procesin e radikalizimit dhe se si t'i përgjigjen atij;

d. rritjen e ndërgjegjësimit ndërmjet autoriteteve lokale mbi praktikat e mira ekzistuese për t'u treguar autoriteteve lokale të cilat mund të kenë frikë, ose nuk janë të pajisura për t'u marrë me situata të tilla, ose për të cilat radikalizmi nuk është prioritet, që shumë qytete në të gjithë Evropën kanë përvojë të konsiderueshme për projekte që mund të shërbejnë si burime të mira në betejën kundër ekstremizmit, për shkëmbime njohurish dhe praktikash më të mira me qytete të tjera evropiane, si në nivelin politik dhe në atë administrativ, përmes takimeve të rregullta duke sjellë së bashku aktorë të ndryshëm lokalë evropianë;

e. nxjerrjen në pah të rolit të rëndësishëm të arsimit, në veçanti lidhur me familjet dhe shkollat, duke u kushtuar vëmendje të veçantë temave të tilla si respekti për diversitetin kulturor, të drejtat e njeriut dhe dëmet e gjuhës së urrejtjes, duke pranuar se të rinjtë, ndonëse veçanërisht të pambrojtur ndaj diskurseve që nxisin urrejtjen dhe dhunën, përderisa gjenden në një periudhë formuese të jetës së tyre, përfshirë dhe luftën për të formuar identitetin vetjak, janë edhe aleatë të fuqishëm në luftën kundër shfaqjeve të urrejtjes përmes lidhjeve të forta me mediat sociale;

f. përfshirjen e shoqërisë civile në punën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit në të gjitha format e shfaqjeve të tyre, përfshirë gjuhën e urrejtjes, antisemitizmin dhe islamofobinë, duke krijuar partneritet me OJQ-të, udhëheqësit e komuniteteve fetare, dhe, në nivelin individual, me ish ekstremistët;

g. mbështetjen e programeve të daljes për individët që duan të largohen nga ekstremizmi, sidomos nga ekstremizmi i orientuar drejt fesë, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile;

h. dhënien e fondeve të nevojshme për aktivitete në këtë sferë, të ndërgjegjshëm për faktin se puna parandaluese duhet të

konsiderohet si zë i zakonshëm i buxhetit me financime të qëndrueshme afatgjata;

i. ndërtimin e aleancave me partnerë të besueshëm, të cilat luftojnë për rutina të përcaktuara qartë për transparencë lidhur me mënyrën se si shpenzohen burimet e alokuara në marrëdhëniet me shoqatat etnike ose fetare, kur atyre u jepet mbështetje financiare, dhe koordinimin e aktiviteteve me qeverisjen rajonale dhe, kur është e përshtatshme, dhe me nivelin e qeverisë kombëtare;

j. zhvillimin e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë që kanë të njëjtat vlera dhe shqetësime me Kongresin dhe, të cilat, janë duke punuar mbi tema të rëndësishme me qëllim luftimin e radikalizimin, të tillë si Forumi Evropian për Siguri Urbane.

7. Të vetëdijshëm se puna kundër radikalizmit është proces i gjatë që ka nevojë të menaxhohet në një kuadër afatgjatë, Kongresi përsërit vendosmërinë e tij për ta mbajtur këtë çështje në axhendën e vet dhe për t'i pasuar rezolutat dhe aktivitetet e veta me vlerësime të rregullta mbi progresin në shtetet anëtare.

II. Memorandum shpjegues[2]

1. Hyrje

1. Sulmet terroriste në Paris dhe Kopenhagë, ku u përfshinë xhihadistë të armatosur duke shkaktuar një numër të përgjithshëm prej 14 viktimash dhe 10 të plagosurish, theksuan nevojën e qyteteve për të bërë më shumë për të trajtuar në mënyrë efektive ekstremizmin. Këto sulme kanë vënë në qendër të vëmendjes çështje me interes: rritja e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe sektarizëm brenda qyteteve, rreziku i rritjes së polarizimit në shoqëri dhe i stigmatizimit të disa komuniteteve, gjuha e urrejtjes në mediat sociale, si dhe rreziku i censurës dhe vetë-censura janë të gjitha rreziqet aktuale me të cilat përballen qytetet.

2 Ky memorandum mirëkuptimi mbështetet në dokumentin e përgatitur nga konsulenti i Këshillit të Evropës Juul van HOOF, Stichting Movisie, i cili mund të vihet në dispozicion nga sekretariati pas depozitimit të një kërkese paraprake.

2. Kongresi ka punuar gjatë dy dekadave të fundit me tema që synojnë krijimin e komuniteteve përfshirëse dhe elastike si mburojë mbrojtëse dhe element për të parandaluar dhe luftuar radikalizimin në nivel lokal dhe rajonal. Në këtë kuadër, ai ka prodhuar rekomandime për luftimin e terrorizmit, promovimin e integrimit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së emigrantëve, dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar, si dhe rezoluta mbi parandalimin e krimit urban, luftën kundër racizmit në nivel lokal dhe rajonal, dhe edukimin për qytetarinë demokratike.

3. Byroja e Kongresit miratoi më 2 shkurt 2015[3] "Strategjinë për të luftuar radikalizmin në nivelin e bazës", e pasuar nga Rezoluta 381 (2015), e cila propozon një sërë aktivitetesh që do të kryhen në kuadrin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë në nivelin lokal dhe rajonal, bazuar në tri shtylla veprimit, përkatësisht në rritjen e ndërgjegjësimit, sinergjitë me organet e Këshillit të Evropës dhe sinergjitë me institucione të tjera.

4. Radikalizmi është në një farë mase çështje "përfshirjeje/ kohezioni", por nuk duhet të neglizhohen as faktorët ideologjikë dhe madje edhe ato fetarë që shpesh janë baza e procesit. Një aspekt që tregon për domosdoshmërinë e një politike të bazuar në përfshirje, për shembull, u theksua nga ish-Presidenti i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Xhovani di Stasi, teksa fliste për rritjen e bashkëpunimit me autoritetet lokale për të frenuar dhunën urbane: "Ne nuk mund të tolerojmë më që pjesë të qyteteve tona të bëhen zona ku nuk mund të shkohet dhe zona të përjashtimit social. E vetmja mënyrë për t'iu përgjigjur këtyre sfidave[4] është përpilimi i një politike të vendosur për integrimin e të gjithë anëtarëve të komuniteteve tona". Radikalizmi është po ashtu çështje që kërkon masa parandaluese, të cilat mund të ofrohen nga autoritetet lokale për shkak të pozicionit të tyre të favorshëm për ta bërë këtë gjë."

3https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CG/2015%2828%2914PROV&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=COE&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=CACC9A&BackColorLogged=EFEA9C#P41_2342

4https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=PR603(2005)&Sector=secDCR&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=1EB1E9&BackColorIntranet=FFCD4F&BackColorLogged=FFC679

5. Edhe pse situata mund të duket e zymtë, duhet një perspektivë pozitive për ta trajtuar këtë çështje në kuadrin afatgjatë, ku nënvizohet se, ashtu si edhe shoqëritë tona po mësojnë të jetojnë së bashku në diversitet, ato do të mësojnë po ashtu të merren me radikalizmin e pjesëve e popullsisë së tyre. Siç theksohet në planin e veprimit të Këshillit të Evropës "Të jetojmë Së Bashku" ("Living Together", "Diversiteti është këtu për të qëndruar gjatë. Ai po formëson të ardhmen e Evropës në një botë që ndryshon shpejt dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë gjë për gjatë. Prandaj është jetike që evropianët t'u përgjigjen sfidave të tij në mënyrën më efektive të mundshme dhe me gjithë zemër, dhe, për ta thënë troç, shumë më mirë se po u përgjigjen aktualisht"[5].

6. Sot shumë qytete në Evropë janë vendi ku bashkohen së bashku njerëz nga dhjetëra kombësi të ndryshme. Të mësuarit e të jetuarit së bashku është proces i ngadalshëm që mund të jetë i dhimbshëm, por edhe një proces i këndshëm. Qeveritë lokale kanë përgjegjësi ndaj atyre që vuajnë efektet e radikalizmit brenda komuniteteve të tyre, të cilat nuk çojnë vetëm në përqafimin e dhunës nga disa anëtarë të komunitetit, por edhe në të folurin dhe të vepruarin në mënyra që shkelin lirinë e shprehjes dhe të fesë. Kongresi ka mbështetur në mënyrë aktive fushatën e Këshillit të Evropës për mospasje të gjuhës së urrejtjes (2012 - 2014), për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me gjuhën e urrejtjes në internet dhe rreziqet që paraqet ajo për demokracinë dhe për të mbështetur dhe për të treguar solidaritet me njerëzit dhe grupet e prekura nga gjuha e urrejtjes në internet.

1.1. Radikalizmi: përkufizimi

7. Radikalizmi në përgjithësi shihet si proces i cili ndonjëherë çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Ky përkufizim është përdorur, për shembull, nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian (KE) dhe nga shumë studiues. KE-ja, në tekstet e saj, e përcakton radikalizmin si "fenomeni i njerëzve që përqafojnë opinione,

5https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008975a

pikëpamje dhe ide që mund të çojnë në akte terrorizmi.[6]" Në këtë drejtim, radikalizmi nuk shihet si proces linear që kalon faza të caktuara me një shpejtësi konstante, por si proces i ndryshueshëm, i cili varet nga konteksti lokal dhe nga faktorë individualë.

8. Ka arsye të shumta që kontribuojnë që individët të radikalizohen, të tilla si mungesa e integrimit në shoqëri, mosangazhimi politik, apo ekspozimi ndaj individëve ekstremistë, grupeve ose organizatave[7]. Konteksti vendor, kulturor dhe shoqëror ndikon në procesin e radikalizmit që reflektohet në përgjigjen e autoriteteve publike. Ndër këto, parandalimi dhe deradikalizmi (dmth., veprimet që synojnë të reintegrojnë personat të cilët janë radikalizuar në shoqëri) dhe jo shtypja janë veprime që përkojnë me qëllimin dhe kompetencat e autoriteteve lokale dhe rajonale.

9. Njohja e faktit se radikalizmi mund të shfaqet më shumë në një nivel më afër individëve vulnerabël në komunitetet më të prekura, koordinimi dhe sinergjia midis niveleve të ndryshme të qeverisjes është dimension i rëndësishëm për mbrojtjen e qytetarëve ndaj këtyre kërcënimeve; i tillë është dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, hulumtuesit dhe profesionistët.

2. Përgjigjet ndaj radikalizimit: tri qasje plotësuese

10. Në Evropë janë ndërmarrë disa nisma me qëllim trajtimin e radikalizimit. Karta Urbane Evropiane e vitit 1992[8] deklaron se politikat e sigurisë dhe të parandalimit të krimit duhet të mbështeten tek parandalimi, zbatimi i ligjit dhe mbështetja e ndërsjellë. Qasjet mund të ndryshojnë në shumë aspekte; në përgjithësi edhe pse ato mund të ndahen në tri kategori të ndryshme, të cilat përdoren aktualisht për ta trajtuar problemin.

11. Represioni si përgjigje ndaj radikalizmit është, tradicionalisht, përgjegjësi e nivelit kombëtar dhe përfshin policimin, legjislacionin dhe aktivitete të inteligjencës. Ky është aspekt i rëndësishëm, por mbetet aspekt mbi të cilin autoritetet lokale në përgjithësi kanë

6.http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/crisis-and-terrorism/radicalisation/index_en.htm
7 http://www.strategicdialogue.org/De-radicalisation_final.pdf
8 https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=887405

ndikim të kufizuar; për këtë arsye represioni apo shtypja nuk është në vëmendje të këtij raporti. Duhet të përmendet po ashtu se represioni në një farë mënyre "është gjithmonë i pranishëm" në qoftë se për një individ mblidhen prova të mjaftueshme, edhe në qoftë se i njëjti person është objekt i një lloj qasjeje parandaluese, ndërsa masat represive janë në dispozicion e në varësi të rrethanave. Në këtë kontekst, ekziston një lidhje ndërmjet represionit dhe parandalimit.

12. Trajtimi i radikalizmit kërkon masa parandaluese. Në kuadrin afatgjatë parandalimi është më racional dhe me kosto më efektive sesa luftimi i simptomave apo i krizave të plota të pranishme. Ai përkon po ashtu dhe me zonën e veprimit *par excellence* për autoritetet lokale, ku ato mund të jenë më efektive dhe ku kompetencat dhe mandatet e tyre janë më të rëndësishme. Që prej vitit 2000, Kongresi, përmes Rezolutës nr. 99, i ka ftuar autoritetet lokale dhe rajonale të zhvillojnë "një qasje më aktive, duke parashikuar edhe parandalimin e problemeve në vend të vetëm trajtimit e tyre më pas, duke favorizuar një qasje afatgjatë më tepër se një qasje afatshkurtër".

13. Përpjekje të tilla normalisht mund të marrin forma të ndryshme. Në fakt, ajo që funksionon në një qytet mund të mos jetë qasja e duhur për një qytet tjetër. Dinamikat vendore luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e masave të suksesshme parandaluese. Është gjithashtu e rëndësishme që të mbahet parasysh se parandalimi i radikalizmit të dhunshëm duhet të jetë pjesë e një strategjie globale për parandalimin. Parandalimi duhet të jetë tërësor, por i integruar edhe në aktivitete të tjera për sigurinë urbane. Kjo pikëpamje është përmbledhur nga Karta Evropiane Urbane në mënyrën e mëposhtme: "Krimi shkaktohet nga një gamë e larmishme shkaqesh. Për pasojë, përgjigjet duhet të jenë si të larmishëm ashtu dhe të koordinuara.[9]"

14. Parandalimi sjell përfitime edhe nga qasja e partneritetit. Ai nuk është vetëm çështje e policisë dhe gjyqësorit; për të qenë efektiv, parandalimi duhet të përfshijë sektorë të tjerë dhe shoqërinë civile. Për shembull, ish-ekstremistët me njohuritë e veçanta që kanë mund

9 Karta Evropiane Urbane 1992.

të luajë rol kyç dhe mund të jenë partnerë të rëndësishëm për qeveritë lokale. Sa i përket ekstremizmit islamik, partneriteti me xhamitë lokale dhe liderët e komuniteteve fetare, mund të përbëjnë po ashtu burime të frytshme për të punuar së bashku kundër ekstremizmit. Megjithatë, është e rëndësishme që këto partneritete të kenë një axhendë më të gjerë se sa tema që kanë të bëjnë në mënyrë rigoroze vetëm me sigurisë. Nëse besimi dhe partneritetet e mira ndërtohen me kalimin e kohës duke punuar mbi tema të ndryshme, futja e çështjeve të sigurisë bëhet më e natyrshme sesa kur një partneritet fillon dhe mbaron me çështjet e sigurisë.

15. Reintegrimi i personave të radikalizuar (dhe të penduar) përbën kategorinë e tretë të përgjigjeve të mundshme. Ashtu si parandalimi, kjo është fushë ku qeveritë lokale kanë kapacitet për të luajtur rol të rëndësishëm. Në fakt, në shumicën e rasteve, këto më me shumë gjasa janë aktivitete që ndodhin në nivelin lokal. Për shembull, në qytetin e Aarhusit, në Danimarkë dhe në Berlin, në Gjermani ekzistojnë dy programe të tilla. Këto qasje ekzistuese u japin përvoja dhe mësime qyteteve të tjera.

a. I ashtuquajturi modeli i Aarhusit për të trajtuar problemin është theksuar shpesh si mënyrë sipas së cilës qytetet mund të punojnë kundër radikalizmit dhe ekstremizmit.[10] Kjo qasje përqendrohet tek përfshirja; me kusht që një individ të mos ketë bërë asgjë kriminale, autoritetet i ndihmojnë individë të tillë të gjejnë mënyrën për t'u kthyer tek komuniteti. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet parasysh rëndësia e kontekstit lokal në mënyrë që puna parandaluese të jetë e suksesshme. Ajo çfarë rezulton e suksesshme në një qytet nuk është e thënë të jetë e suksesshme në një qytet tjetër. Qeveritë lokale i njohin më mirë njësitë e tyre.

b. Strategjia e Komisionit Evropian për "Luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm" (CVE) reflekton vëmendjen ndërkombëtare në rritje për metodat parandaluese ndaj dhunës transnacionale[11]. CVE-ja është më e gjerë sesa vetëm islamizmi i dhunshëm apo shfaqjet e

10.http://cir.au.dk/fileadmin/site_files/filer_statskundskab/subsites/cir/radicalization_aarhus_FINAL.pdf
11 http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-18_en.htm

dhunës të lidhura me IS-in. Strategjia trajton të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm, pavarësisht nga ideologjia dhe përqendrohet jo në të menduarit ose të folurit radikal, por në parandalimin e sulmeve të dhunshme.

3. Sigurimi dhe siguria si të drejta themelore

16. Në Rekomandimin 80 (2000) për krimin dhe pasigurinë urbane në Evropë, Kongresi ka theksuar se autoritetet lokale kanë rol kyç për të luajtur në parandalimin dhe uljen e krimit dhe se, për pasojë, autoritetet kombëtare duhet të forcojnë përgjegjësitë dhe burimet që u japin qeverive vendore për këtë qëllim.

17. Në vitin 2006, Kongresi miratoi një rekomandim të dytë (Rekomandimi 197) për sigurinë urbane në Evropë, ku nënvizohet se siguria urbane kërkon përfshirjen e fushave dhe specialiteteve të ndryshme shumëdisiplinore të cilat nuk lidhen vetëm me policinë dhe gjyqësorin, por edhe me sektorë të tjerë të administratës dhe sferës sociale. Ai i ftoi po ashtu shtetet anëtare "të garantojnë sigurinë e qytetarëve të tyre ndërsa sigurojnë plotësisht të drejtat e njeriut dhe liritë themelore".[12]

18. Politikat e sigurisë duhet të projektohen dhe të ndërtohen rreth nevojave individuale dhe kolektive të qytetarëve dhe jo sipas institucioneve publike. Për ta bërë këtë, duhet të promovohet në mënyrë universale pjesëmarrja e qytetarëve. Shoqëria civile duhet të luajë rol në të gjitha fazat. Sjellja së bashku e të gjitha forcave të nevojshme për t'i trajtuar problemet në kompleksitetin e tyre është pjesë thelbësore e kësaj qasjeje. Për të rritur në maksimum efikasitetin, është e nevojshme të theksohet rëndësia e partneritetit. Po aq e rëndësishme është edhe nevoja për të analizuar problemet në kompleksitetin e tyre, për të vlerësuar dhe për të përdorur zgjidhje të mbështetura në prova. Të gjitha politikat duhet të marrin parasysh njohuritë e fundit teknike dhe shkencore.

19. Në lidhje me sigurinë urbane, shpesh nevojitet një qasje ndërinstitucionale për zhvillimin, zbatimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për masat e sigurisë. Edhe pse përcaktimi i strategjive të sigurisë është kompetencë e nivelit të qeverisjes kombëtare,

12 https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=983773&Site=Congress

autoritetet lokale mund të luajnë rol vendimtar në trajtimin e dilemës së "sigurisë përkundrejt lirisë", për shkak të afërsisë së tyre me qytetarët; ato mund të veprojnë si ndërmjetës. Qeveritë lokale mund të punojnë për arritjen e kohezionit social dhe për të shmangur konfliktet që shpërthejnë në dhunë përmes nxitjes së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe dialogut mes komuniteteve.

4. Strategjitë ndërinstitucionale: partnerët për ta kryer këtë punë

20. Qytetet duhet të kenë një ide (duke identifikuar dhe mobilizuar strukturat ekzistuese) lidhur me personat të cilët mund të ndihmojnë për të kuptuar çështjet në fushën e tyre në mënyrë që të krijojnë partneritete funksionale - ne këtë mund ta quajmë koalicion gatishmërie - dhe të përfshijnë aktorë të rinj, të tillë si qytetarë, OJQ, udhëheqës të komuniteteve fetare, familje, të rinj, shkolla, blogerë interneti, punonjës socialë etj. Autoritetet lokale mund të bëjnë më shumë për të formuar partneritete lokale dhe për të punuar së bashku për këtë çështje dhe, për shembull, në rastin e radikalizmit islamik, mund të krijojnë një kuadër të përbashkët vlerash me organizatat myslimane.

21. Ka disa nisma premtuese lokale (si, për shembull, ajo e Kopenhagenit, Aarhusit, Berlinit, Londrës, Vilvoordes, Brukselit) lidhur me trajtimin e radikalizmit, nga të cilat mund të mësojnë dhe qytetet e tjera.

22. Për shembull, projekti *Hayat* (termi në gjuhën arabe dhe turke për 'jetën') në Berlin, i drejtuar nga Qendra për Kulturë Demokratike (ZDK GmbH), përqendrohet në këshillim dhe mbështetje për individët dhe familjet në rrezik për ekstremizëm të dhunshëm islamik[13]. Projekti ka katër të punësuar me kohë të plotë, përveç personave që punojnë në terren me orë. Stafi i projektit përfshin psikologë, kriminologë dhe islamologë.

23. Një pjesë gjithnjë në rritje e punës së tyre përqendrohet në mbështetjen e familjeve të njerëzve të cilët kanë udhëtuar ose kanë ndërmend të udhëtojnë për në Siri për të luftuar për një grup të frymëzuar nga al-Qaeda. Veprimet e tyre financohen nga shteti, nga Zyra Federale për Migracionin dhe Azilkërkuesit (Bundesamt für

13 http://hayat-deutschland.de/english/

Migration und Flüchtlinge, BAMF). Një qëllim i programit është që të fuqizojë të afërmit për të menaxhuar më mirë radikalizmin brenda familjes. Përvoja e tyre tregon se shpesh ekziston konflikt brenda familjes që duhet të lihet pas para se të mund të fillohet në një mënyrë kuptimplote ndonjë mbështetje për deradikalizmin e personit në fjalë. Në këtë mënyrë, projekti shërben edhe si lidhje ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve të sigurisë. Në pranverën e vitit 2015, projekti kishte rreth 130 raste, 50 prej të cilave janë përfunduar dhe 21 janë identifikuar si qartazi të suksesshme për shkak të mbështetjes së dhënë. Vetëm në një rast pas fillimit të këshillimit zhvillimet kanë qenë negative.

24. Një burim i mirë për qytetet është Rrjeti për Ndërgjegjësimin ndaj Radikalizmit, i BE-së, i cili i lidh profesionistët nga e gjithë Evropa për të ndarë përvojat dhe për të mësuar nga njëri-tjetri. Rrjeti përmban një koleksion në rritje të praktikave për iniciativat kundër radikalizmit dhe shërben si burim i dobishëm për qytetet[14]. Mbledhja e praktikave përfshin projekte mbi temat e mëposhtme:

a. ndërgjegjësimi i profesionistëve të vijës së parë;
b. strategjitë e daljes: de-radikalizmi dhe shkëputja;
c. mbushja e hendeqeve përmes dialogut;
d. angazhimi dhe fuqizimi i komunitetit;
e. edukimi i të rinjve;
f. mbështetja dhe fuqizimi i familjeve;
g. ofrimi i kundër-komunikimit;
h. krijimi i një infrastrukture institucionale.

5. Veprimet në terren: çfarë mund të bëjnë qeveritë lokale?

25. Për sa u përket masave parandaluese, autoritetet lokale kanë në dispozicion një mozaik ndërhyrjesh për të trajtuar radikalizmin, disa pjesë të të cilit janë paraqitur më poshtë. Është e rëndësishme për qytetet që të vijojnë të zhvillohen në këtë fushë, pavarësisht legjislacionit të veçantë në këtë drejtim.

a. Hartimi i strategjive gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale lokale: Në nivelin lokal, qytetet duhet të zhvillojnë një plan veprimi (skicim lokal

[14] http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/index_en.htm

i situatës, duke përcaktuar linjat e veprimit dhe krijimin e organeve koordinuese), të shpërndajnë burimet për të luftuar radikalizmin dhe të marrin masa konkrete që mund të ndiqen, dhe të bëjnë koordinimin me nivele të ndryshme të qeverisjes. Lidhur me koordinimin dhe zhvillimin e efekteve të sinergjisë midis palëve pjesëmarrëse, një rekomandim i mëparshëm nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale thekson se "është thelbësore që të dhënat, informacioni dhe të menduarit në lidhje me sigurinë urbane të mund të grumbullohen në një strukturë të përbashkët në mënyrë të tillë që të rritet dituria dhe të lehtësohet vendimmarrja[15]."

b. Ngritja e ndërgjegjësimit ndërmjet aktorëve: Është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi ndërmjet palëve të interesuara për një partneritet lokal për siguri dhe të sigurohet trajnim adekuat i aktorëve të ndryshëm. Për shembull, një grup i tillë aktorësh janë profesionistët e vijës së parë që punojnë me individë apo grupe në rrezik. Grupe të tjera mund të përfshijnë personelin e burgut, punonjësit socialë, mësuesit, dhe punonjësit e shëndetësisë. Një trajnim i tillë do të ndihmonte në zhvillimin e të kuptuarit të procesit të radikalizmit dhe mënyrës se si t'i përgjigjesh atij.

c. Rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet autoriteteve lokale për praktikat e mira ekzistuese: Disa autoritete lokale mund të kenë frikë se nuk janë plotësisht të pajisura për t'u marrë me situatën, apo se radikalizmi nuk përbën prioritet për ta. Atyre u duhet treguar se ka informacion dhe njohuri për këtë temë dhe se shumë qytete evropiane kanë përvojë të konsiderueshme në projekte që nxisin vlerat demokratike, të cilat mund të shërbejnë si burim i mirë në luftën kundër ekstremizmit.

d. Arsimimi: Roli i rëndësishëm i arsimit duhet theksuar, veçanërisht në lidhje me familjet dhe shkollat. Thuhet shpesh se familjet kanë mundësi unike për ta zbuluar radikalizmin, por në mënyrë që ato të veprojnë dhe të përballen në mënyrë produktive me radikalizmin, familjet shpesh kanë nevojë për informacion dhe mbështetje. Arsimimi në drejtim të të rinjve mbi tema të gjera, të tilla si toleranca,

15 Rekomandim 197 (2006) për sigurinë urbane në Evropë
https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=983773&Site=Congress

respektimi i të tjerëve dhe të drejtat e njeriut është gjithashtu i rëndësishëm. Shkollat kanë rol për të luajtur në lidhje me bërjen e shoqërisë më elastike dhe parandalimin e radikalizmit pavarësisht ideologjisë. Të rinjtë janë veçanërisht të pambrojtur nga diskurset që nxisin urrejtjen dhe dhunën pasi ata janë në një periudhë formuese, që përfshin dhe luftën për formimin e identitetit individual. Kriza të tilla identiteti mund të përdoren nga rekrutuesit e grupeve ekstremiste për t'u dhënë të rinjve përgjigje të qarta, bardhë e zi për problemet e jetës. Në anën tjetër, ndonëse vulnerabël, të rinjtë janë edhe aleatë të fuqishëm në luftën kundër shfaqjeve të urrejtjes, siç është treguar me pjesëmarrjen e tyre aktive me anë të mediave sociale në fushatën e Këshillit të Evropës "Jo gjuhës së urrejtjes!".

e. Komunikimi i strategjive dhe veprimeve për publikun e gjerë duhet të jetë i balancuar, i përgjegjshëm dhe, në përgjithësi, duhet të privilegjohet diskursi i integrimit. Në të njëjtën kohë, komunikimi nuk duhet të jetë shumë i ndjeshëm për t'u rënë gjërave në kokë. Kërkohet ekuilibër ndërmjet dhënies së qartë të mesazhit, pa stigmatizuar grupe të veçanta.

f. Mbështetja e programeve të daljes për individët që duan t'i largohen ekstremizmit, veçanërisht ekstremizmit të orientuar drejt fesë. Programe të tilla mund të luajë rol kyç në këtë proces dhe shpesh mund të përfitojnë nga fakti që drejtohen në nivelin lokal. Qeveritë lokale mund të ndihmojë për të krijuar dhe/ose shpërndarë burime për të krijuar programe të tilla.

g. Shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm në punën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit në të gjitha shfaqjet e tyre, përfshirë gjuhën e urrejtjes, antisemitizmin dhe islamofobinë, duke nxitur kohezionin social dhe ndjenjën e përkatësisë në shoqëri. Kjo mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, për shembull, nëpërmjet punës së OJQ-ve, bashkësive fetare dhe punës në nivelin individual nga ish ekstremistët. Për sa i përket ekstremizmit islamik, liderët dhe komunitetet myslimane janë të pozicionuar mirë për të marrë një rol aktiv. Disa e kanë bërë tashmë këtë gjë, por shumë struktura të tjera të ngjashme kanë qëndruar të qeta ose nuk kanë bërë mjaftueshëm kur të rinjtë i janë drejtuar ekstremizmit. Komunitetet myslimane

janë partner vital në punën parandaluese dhe qytetet kanë nevojë të krijojnë lidhje të mira dhe për të inkurajuar punën e tyre parandaluese. Në rastin e xhamive radikale, qytetet duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë presion dhe të flasin qartë në lidhje me vlerat e lirisë dhe demokracisë.

h. Financimi i masave të propozuara: Në shumë raste, kjo çështje është e përcaktuar nga autoritetet lokale, të cilat kanë përgjegjësinë të vendosin se çfarë buxheti të caktojnë. Është e rëndësishme të mos e shohim punën parandaluese si diçka që mund të zgjidhet lehtë, por të sigurohemi që kjo çështje të bëhet zë i zakonshëm i buxhetit me financime të qëndrueshme afatgjata.

i. Financimi dhe kërkimi për partnerë lokalë: transparenca në marrëdhëniet e autoriteteve lokale me shoqatat etnike ose fetare, kur atyre u jepet mbështetje financiare, është e rëndësishme. Autoritetet lokale duhet të jenë të kujdesshme për të mos ndërtuar aleanca me partnerë të gabuar, por me partnerë të besueshëm dhe duhet të përpiqen të përcaktojnë rutina të qarta për transparencë lidhur me mënyrën sesi shpenzohen burimet e ofruara. Mund të ketë rrethana ku qytetet kanë vështirësi në trajtimin e situatës vetë. Në këto raste, do të ishte e dobishme të merrej ndihmë nga niveli rajonal apo edhe nga niveli kombëtar i qeverisjes.

6. Përfundime

26. Numri alarmues i luftëtarëve të huaj evropianë në Siri, sulmet terroriste në Paris dhe Kopenhagë, si dhe kërcënimi nga ekstremizmi i djathtë, janë të gjitha shenja paralajmëruese se qytetet kanë nevojë për më shumë punë efektive parandaluese për t'i larguar nga ekstremizmi njerëzit në rrezik ekstremizmi. Ndryshe nga legjislacioni, i cili në shumicën e rasteve është çështje e nivelit kombëtar, zona e parandalimit është në përgjithësi çështje lokale dhe në një masë të madhe u takon vetë qyteteve ta formësojnë dhe përvetësojnë atë. Kjo është, siç u tha më lart, zonë *par excellence* e qeverisjes lokale.

27. Tashmë në Evropë ka disa qytete që i kanë marrë seriozisht këto shenja paralajmëruese dhe janë përgjigjur duke punuar në mënyrë të strukturuar për të parandaluar radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Këto qytete kanë ndërtuar njohuri dhe struktura nga të

cilat mund të mësojnë qytetet e tjera, të cilat ato mund t'i përshtatin për nevojat e tyre specifike mbështetur në dinamikat lokale. Ka edhe njohuri të shkëlqyera në dispozicion, për shembull, nëpërmjet Rrjetit për Ndërgjegjësimin ndaj Radikalizmit i BE-së (RAN), përfshirë dhe mbledhjen e praktikave të projekteve të tjera në qytete të tjera për të mësuar, për të gjetur frymëzim dhe për të marrë informacion mbi sigurinë urbane nga Forumi Evropian për Siguri Urbane (EFUS).

28. Qeveritë lokale do të kenë nevojë për mbështetjen dhe partneritetin e familjeve, komuniteteve fetare dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në shoqërinë civile për të ndërtuar fleksibilitetin vendor dhe punën efektive parandaluese. Për nisjen dhe formësimin e partneriteteve të tilla, autoritetet lokale do të duhet të ndërmarrin iniciativën për kërkimin e partnerëve të besueshëm lokalë. Kongresi e ka theksuar tashmë këtë pikë në një rekomandim të mëparshëm duke: "theksuar rolin e rëndësishëm të autoriteteve lokale dhe rajonale për organizimin e një partneriteti të ri për sigurinë urbane që përfshin të gjithë lojtarët socialë (grupet e popullsisë dhe qytetarët) dhe profesionistët e sigurisë (policinë dhe gjyqësorin) me synimin e krijimit të një sistemi efektiv, demokratik dhe të integruar të policimit lokal[16]".

29. Shumë qytete në Evropë ka të ngjarë të përballen me problemin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për shumë vite në vijim. Kur problemi është afatgjatë, zgjidhjet duhet të jenë po ashtu afatgjata. Reagimet në minutën e fundit kanë të ngjarë të jenë më të kushtueshme dhe më pak efektive krahasuar me punën parandaluese të strukturuar dhe të menduar mirë.

30. Përmbushja e këtij roli u takon shumë qyteteve të Evropës dhe qeverive lokale dhe rëndësia e marrjes përsipër me sukses të kësaj detyre zor se mund të mbivlerësohet.

16 Rekomandimi 216 (2007) për policimin në komunitet: autoritetet lokale dhe rajonale që garantojnë një partneritet të ri.
https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1123875&Site=Congress

Ky tekst shtjellon, nga njëra anë, konceptin e radikalizimit dhe shqyrton qasje të ndryshme për trajtimin e problemeve të tilla si ndëshkimi, parandalimi dhe reintegrimi i personave të radikalizuar. Ai paraqet shembuj konkretë nga niveli lokal dhe rajonal i qeverisjes në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ai përfshin gjithashtu dhe çështjet e sigurimit dhe të sigurisë urbane, duke pranuar se siguria është pjesë e të drejtave themelore dhe duke theksuar nevojën për të balancuar masat e marra për të luftuar radikalizimin përkundrejt normave të të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe qëllimit për të ndërtuar shoqëri përfshirëse dhe kohezive.

Udhëzimet rekomandojnë që autoritetet lokale dhe rajonale të hartojnë strategji projektimi për ta përfshirë shoqërinë civile në punën e tyre kundër ekstremizmit në të gjitha manifestimet e tij, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, antisemitizmin dhe ndjenjat dhe veprimet antimyslimane. Autoriteteve lokale dhe rajonale u kërkohet t'ua komunikojnë strategjitë e tyre publikut të gjerë në mënyrë të balancuar dhe të përgjegjshme, të shkëmbejnë informacion mbi praktikat e mira, të mbështesin programet e daljes për individët që duan të largohen nga ekstremizmi dhe të planifikojnë burime për të luftuar radikalizimin. Autoritetet lokale dhe rajonale ftohen të ndërtojnë aleanca me partnerë të tjerë për të zhvilluar koordinimin në nivel rajonal për sa u përket aktiviteteve të tyre për këto çështje.

www.coe.int/congress-intercultural
congress.intercultural@coe.int
Botuar në: mars 2016

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale është një institucion i Këshillit të Evropës, përgjegjës për forcimin e demokracisë lokale dhe rajonale në 47 shtetet anëtare të tij. I përbërë nga dy dhoma - Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Rajoneve - dhe tre komisione, ai sjell së bashku 648 zyrtarëve të zgjedhur që përfaqësojnë më shumë se 200.000 autoritetet lokale dhe rajonale.

The Congress
Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE